




2677/6 21.11.2025

MINISTRIA FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANES KAPSHTICE



**LËNDA:** Kërkesë për shpallje publike

**DREJTUAR:** DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

**DREJTUAR:** DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Korçë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Korçë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për vendimin per rikuperim me force te borxhit doganor, per ;

**Subjekti:** "DEJAN STOJAN" me NIPT M33920001S

**Vendimi :** Nr 2677 date 11/09/2025

**Detyrimi:** 478.485 leke detyrime, 478.485 leke penalitete si edhe kamate vonesat qe aplikohen mbi detyrimin.

Kerkesa paraqitet mbeshtetur ne faktin se subjekti nuk eshte njoftuar ne adresen e deklaruar ndaj, lutemi qe për vazhdimin e procedurave ligjore, me tej pasi per rikuperimin e borxhit doganor, është domosdoshmëri shpallja publike dhe data e shpalljes publike(bashkëlidhur vendimi Nr 2677 date 11/09/2025.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE

DRITAN ÇEKANI



MINISTRIA FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANES KAPSHTICE  
VENDIM

Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të subjektit  
debitorit "Dejan Stojani" P.F me NIPTM33920001S me adrese Korçe Lagjja 17, Rruga  
"Insan Korça", Objekti nr.3, Hyrja 2 7001

Dega e Doganës Kapshticë, me Vendimin Nr 163 date 31/07/2025 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën 478.485 leke detyrime doganore dhe 478.485 leke penalitete leke si edhe kamate vonesat te cilat rillogariten mbi detyrimin doganor.

Ky vendim i është komunikuar debitorit më datë 05/08/2025 me aktin Nr 1415/3 prot, vendim për te cilin nuk është shlyer borxhi doganor i kontabilizuar si me sipër dhe i percaktuar në vendimin administrativ, njekohesisht nuk rezulton ankim administrativ i ushtruar, sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte, në bazë të vendimit të sipërpërmendur të Degës së Doganës Kapshticë, me qëllim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, të percaktuar në Vendimin Nr 163 date 31/07/2025 që debitori "Dejan Stojani" P.F me NIPTM33920001S me adrese Korçe Lagjja 17, Rruga "Insan Korça", Objekti nr.3, Hyrja 2 7001, ka ndaj Degës së Doganës Kapshticë, në zbatim të nenit 280, 283 të K.Doganor dhe nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile

VENDOSA QË:

- 1.Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të cmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 2.Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personavë të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 3.Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme në masën e percaktuar në vendimin Nr 163 date 31/07/2025, si dhe të kamatë vonesave të lindura në bazë të nenit 280 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

Kryetari i Degës së Doganës Kapshticë

DRITAN ÇEKANI

